



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 775/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Afiete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Sanije Dubova, kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Obiliq, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike të Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Sanije Dubova, kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Obiliq, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike të Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, me shenjën ZL.Anr.775/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017,

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.775/2017 me datën 09.11.2017, nga Sanije Dubova, kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Obiliq, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike të Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se ka pasur parregullsi në këto Qendra të Votimit: në Obiliq, shkolla fillore “Ibrahim Rugova” 1501R/01, 02, 03, 04, 05, 06, 07, 08, 09 e posaqërisht 1501e/05; në Breznicë 1503e/01, 02; në Milloshevë, shkolla fillore “Hasan Prishtina” 1502e/01, 02, 03 dhe në Raskovë 1513e/01,02.

Parashtruesja i ankesës ka bashkangjitur deklaratat e dëshmitarëve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankueses gjeti se ankuesja me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar dhe nuk ka identifikuar se sa vota i mungojnë në vendvotimet në të cilat pretendon se ka pasur parregullsi. Prandaj Paneli ankesën e ankueses e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë ankesën e ankueses e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL.Anr.775/2017 më datën 10.11.2017.

Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*